



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 23 prill u mbajt konferenca mbi ecurinë e çështjes gjyqësore. Seanca filloi me disa urdhra gojorë nga Trupi Gjyqësor. Ndër të tjera, Trupi Gjyqësor vendosi lidhur me disa kërkesa të Prokurorisë dhe Mbrojtjes për pranimin e disa materialeve si prova. Trupi Gjyqësor i miratoi kërkesat kur konstatoi se provat ishin relevante, autentike, dhe se pranimi i tyre nuk zhbëhej prej efektit dëmtues. Materialet që nuk përmbushnin kriteret ose që nuk ishin relevante nuk u pranuan.

Më tej, Trupi Gjyqësor miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Veselit dhe Mbrojtjes së Thaçit për të pasur qasje dhe për të përdorur disa dokumente nga çështjet gjyqësore të Salih Mustafës; Pjetër Shalës; Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Sipas arsyetimit të Trupit Gjyqësor, këto çështje përkojnë pjesërisht me çështjen gjyqësore aktuale. Megjithatë, Trupi Gjyqësor u rikujtoi palëve se masat mbrojtëse të urdhëruara në çështjet gjyqësore të tjera, vijnë të jenë të vlefshme.

Gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes, ekipet e Mbrojtjes njoftuan se synojnë të dorëzojnë mocion të përbashkët ku do të kërkojnë rrëzimin e të gjitha akuzave, ose të disa prej tyre. Trupi Gjyqësor caktoi si afat për dorëzimin e këtij mocioni datën 2 qershor, ose 14 ditë pas vendimit të fundit të Trupit Gjyqësor për pranimin e provave në këtë çështje gjyqësore, cilado të jetë data e mëvonshme. Prokuroria u urdhërua të dorëzojë përgjigje ndaj mocionit, nëse do të ketë, deri më 1 korrik, ose deri 30 ditë pas dorëzimit të mocionit të Mbrojtjes. Trupi Gjyqësor theksoi se pas kësaj nuk do të pranojë kundërpërgjigje prej ekipeve të Mbrojtjes.

Mbrojtësi i viktimave njoftoi se synon të thërrasë dy dëshmitarë ekspertë, që tashmë i kanë përgatitur aktekspertizat, njëra lidhur me dëmin psikologjik dhe psikiatrik ndërsa tjetra lidhur me dëmin material. Mbrojtësi i viktimave ende nuk e dinte sa prej viktimave që nuk kanë dhënë dëshmi deri më tani do të dëshmojnë në kuadër të paraqitjes së provave nga Mbrojtja e Viktimave, nëse do të ketë. Mbrojtësi i viktimave parashikoi se do t'i nevojitet gjithsej një javë për paraqitjen e provave të tij.

Trupi Gjyqësor urdhëroi mbrojtësin e viktimave të jetë gati për paraqitjen e provave në korrik.

Më tej, Trupi Gjyqësor caktoi 28 majin si afat për Mbrojtjen e Viktimave që të dorëzojë listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë, bashkë me një përmbledhje se çfarë pritet të thonë si dhe kohëzgjatjen e parashikuar të marrjes në pyetje të tyre. Gjithashtu, Mbrojtja e Viktimave u urdhërua të dorëzojë një listë me provat





materiale brenda të njëjtit afat. Trupi Gjykues u kërkoi palëve që t'i dorëzojnë kundërshtimet e mundshme ndaj parashtrimit të Mbrojtjes së Viktimave deri më 9 qershor.

Mbrojtësi i viktimave informoi se do të përgatisë një listë me deklaratat e viktimave për të treguar dëmin që u është shkaktuar, dhe Trupi Gjykues vendosi se këto deklarata duhet t'u vihen në dispozicion palëve në vijimësi dhe dhënia e tyre duhet të përfundojë më së voni deri më 1 korrik.

Trupi Gjykues anuloi datat e seancave që ishin parashikuar në kalendarin e tanishëm të Gjykatës, dhe rifillimi i këtij gjykimi shtyhet deri në një njoftim të ardhshëm.

Rrjedhimisht, seanca gjyqësore e ardhshme që do të zhvillohet në Gjykatë është seanca e apelit në çështjen *Pjetër Shala*, më 15 maj në orën 13:30.

Më 17 prill 2025, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese lëshoi vendim lidhur me kërkesën referuese të paraqitur nga Salih Mustafa, ku ajo konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të Kushtetutës së Kosovës apo të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Z. Mustafa paraqiti ankesë për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, me pretendimin se Trupi Gjykues dhe Paneli i Apelit nuk kishin dhënë arsyetim për vendimin e fajësisë për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme. Në lidhje me këtë, Dhoma Kushtetuese nuk gjeti ndonjë gabim faktik apo juridik në arsyetimin e dhomave gjyqësore penale që do të vinte në pikëpyetje konstatimet e tyre.

Z. Mustafa gjithashtu u ankua se Paneli i Gjykatës Supreme nuk kishte identifikuar saktë ligjin më të butë të Kosovës për qëllimet e dënimit të tij. Për këtë aspekt, Dhoma Kushtetuese rikujtoi se, sipas Kushtetues së Kosovës, Dhomat e Specializuara funksionojnë në përputhje me kornizën ligjore të tyre. Rrjedhimisht, të drejtat dhe liritë themelore që garantohen në Kreun II të Kushtetutës së Kosovës zbatohen në pajtim me atë kornizë autonome. Më tej, Paneli konstatoi se i vetmi ligj i detyrueshëm i zbatueshëm para Dhomave të Specializuara është Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Sipas këtij Ligji, dhomat gjyqësore penale nuk janë të detyruara të zbatojnë ligje të tjera të Kosovës kur përcaktojnë dënimet për krime ndërkombëtare, por vetëm që t'i mbajnë parasysh ato. Për rrjedhojë, Dhoma Kushtetuese konstatoi se pretendimi i z. Mustafa për shkelje të Kushtetutës së Kosovës ose Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut nuk qëndronte.

